



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1571/6 prot.

Datë 08.07.2025

V E N D I M
Nr. 858/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.07.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik Besim Ksamberi, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar- mallra”, me Nr. REF:48564-05-21-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrimi”, me fond limit 2.200.000 (dy milion e dyqind mijë) lekë pa TVSH zhvilluar më datë 03.06.2025, nga autoriteti kontraktor Bashkia Rrogozhinë.

Vazhdim i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

Ankimues: Operatori ekonomik Besim Kamberi me Nipt L42103023G dhe adresë: Rruga e Qelqit , Zona Kadastrale Nr 3866 Nr Pasurie 310/20 - Kashar, Tiranë.

Subjekt i interesuar: Bashkia Rrogozhinë
Adresa: Lagjja NR.1, Rruga e Kavajës, Rrogozhinë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi besim Kamberi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 22.05.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar- mallra”, me Nr. REF:48564-05-21-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrimi”, me fond limit 2.200.000 (dy milion e dyqind mijë) lekë pa TVSH zhvilluar më datë 03.06.2025, nga autoriteti kontraktor Bashkia Rrogozhinë.

II.2. Në datën 03.06.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 12.06.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës

me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “ART cleaning company” SHPK	1,451,800 lekë	kualifikuar
2. “ATLANTIK 3” SHPK	1,477,000 lekë	skualifikuar
3. BESIM KAMBERI	1,220,500 lekë	skualifikuar
4. “Biotek” SHPK	1,334,150 lekë	skualifikuar
5. “Euro Mega 2010” SHPK	1,290,150 lekë	kualifikuar
6. “Loft Conctruction” SHPK	1,795,500 lekë	skualifikuar
7. “MURATI D” SHPK	1,366,400 lekë	skualifikuar
8. “Pastrime Silvio” SHPK	1,651,100 lekë	kualifikuar
9. “T & J construction” SHPK	1,662,000 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 12.06.2025 operatori ekonomik Besim Kamberi është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

“ Ofertë anomalisht e ulët. Nuk ka paraqitur deklarat që merr përsipër kryerjen e transportit të mallrave”.

II.5. Në datën 16.06.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik *“Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak”* për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.6. Në datën 18.06.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa e operatorit ekonomik Besim Kamberi me numër ankimimi elektronik A/2025/5433 datë 18.06.2025 dhe me Nr. 1571/2025 Prot., datë 18.06.2025 ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike me pretendimet si vijon:

“ A- Sa i takon arsyes se skualifikimit “Nuk ka paraqitur deklarate qe merr persiper transportin e mallrave” sqarojme si me poshte:

Shoqeria jone ka dorezuar ne SPE dokumentin me emertimin iDeklaratat”. Nga verifikimi jone ky eshte nje dokument i cili ndodhet sebashku me dokumentat e tjere dorezuar ne menyre elektronike. Permbajtja e deklarates eshte e sakte dhe si e tille duhet te merret ne konsiderate. Lidhur me kete pike, kerkojme nga KSHA, verifikimin e sakte ne SPE te ketij dokumenti, bashkelidhur ankeses po ju vendosim ne dispozicion dhe dokumentin perkates.

Besojme se eshte nje lapsus nga ana e AK dhe kerkojme korrigjimin e tij.

Sa me siper arsya e skualifikimit nuk qendron dhe shoqeria jone duhet te kualifikohet.

B. Lidhur me arsyen e skualifikimit iOferta anomalisht e ulet” sqarojme se: Mbeshtetur ne renditjen e mesiperme dhe referuar pikes 4, Neni 82, VKM 285 e perditesuar:

i4. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e

vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: - Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur; - Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. 80 Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit/ët, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së. Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë: O - Oferta MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme N - Numri i ofertave të vlefshme PR (Zm) – Zbritje e mundshme $MO = O1 + O2 + O3 + \dots + On / N$ $PR = 85 \% Mo$ Vlera e ofertave të vlerësuara .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët. Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.”, na rezulton qe cdo oferte nen vleren 1 192 900,62 leke pa tvsh te llogaritet si oferte anomalisht e ulet.

Sipas AK ofertat e kualifikuara jane:

Operatorët ekonomik	Vlerat të ofertuara	Refuzuar
BESIM KAMBERI	1 220 500	Po
EURO MEGA 2010	1 290 250	Jo
ART cleaning company	1 451 800	Jo
Pastrime Silvio	1 651 100	Jo

Ne kete renditje po rendisim dhe shoqerine tone pasi arsya me siper e skualifikimit nuk qendron, gjithashtu nese do te ishim skualifikuar per dokumentacion nuk kishte perse te cilesohej arsya tjeter mbi oferten anomalisht te ulet.

$$5\,613\,650 / 4 = 1\,403\,412.5$$

$$1\,403\,412.5 \times 0.85 = 1\,192\,900.62 \text{ leke}$$

Nderkohe qe oferta jone eshte me e madhe se kaq ne vleren 1 220 500 leke, me nje diference prej 27 599.38 leke me teper se oferta anomalisht e ulet.

Besojme se edhe kjo arsye skualifikimi eshte nje lapsus i AK dhe kerkojme nga KSHA llogaritjen e sakte te ofertes anomalisht te ulet.

Sa me siper kjo arsye skualifikimi nuk qendron dhe AK duhet te kualifikojte oferten e shoqerise sone.”

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin,

adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1571/1 prot., datë 19.06.2025, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik Besim Kamberi kundërshton me anë të ankesës me nr. 15711 prot, datë 18.06.2025.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se në datën 20.01.2025 pranë Komisionit Prokurimit Publik është protokolluar më shkresën nr. 131/2 prot “*Formulari i Paraqitjes së Argumentave nga Operatori Ekonomik i “EURO MEGA” SHPK*”, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik Besim Kamberi.

II.9. Nëpërmjet shkresës me nr. 2571/2/7 prot., datë 30.06.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1571/3 prot., datë 02.07.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor vendimi K.SH.A.-së mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur pranim të ankesës së operatorit ekonomik Besim Kamberi lidhur me deklaratën për transportin e mallrave objekt prokurimi dhe mos pranim të ankesës lidhur me vlerësimin e ofertës si anomalisht të ulët.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1 Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik Besim Kamberi për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik e tij me arsyet për mosplotësimin e kriterëve për kualifikim si më poshtë vijnë:

“ *Nuk ka paraqitur deklarat që merr përsipër kryerjen e transportit të mallrave*”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Nëpërmjet shkresës me nr. 2571/2/7 prot., datë 30.06.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1571/3 prot., datë 02.07.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor vendimi K.SH.A.-së mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur pranim të ankesës së operatorit ekonomik Besim Kamberi lidhur me deklaratën për transportin e mallrave objekt prokurimi.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas

parashikimeve të nenit 115, pikat 2 të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115 pika 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: *2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.*

Duke qenë se pretendimi i mësipërm i operatorit ekonomik ankimues rezulton, se është pranuar nga autoriteti kontraktor, **për këtë arsye KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar të ankesës.**

III.2. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik Besim Kamberi për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik e tij me argumentimin “*Ofertë anomalisht e ulët*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: [...]1. “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.” [...]

III.2.2. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “.....**Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme**.....Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: - Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. - Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së. - Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.2.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së me shkresën nr. 2571/2/7 prot., datë 30.06.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1571/3 prot., datë 02.07.2025, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar- mallra”, me Nr. REF:48564-05-21-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrimi”, me fond limit 2.200.000 (dy milion e dyqind mijë) lekë pa TVSH zhvilluar më datë 03.06.2025, nga autoriteti kontraktor Bashkia Rrogozhinë kanë ofertuar 9 operatorë ekonomikë nga të cilët 5 operatorë rezultojnë se ***përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të vlefshme*** në respektim të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Mbi bazën e këtij kualifikimi KVO-ve duhet të aplikojë formulën për ofertën/ofertat anomalisht të ulët/ulta mbështetur në përcaktimet ligjore të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe DST. Ndërkohë KVO-ja dhe KSHA-ja përlllogaritjen e ofertës anomalisht të ulët e kanë llogaritur mbi mesataren e të gjithë ofertave të 9 operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurë duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet qartë që aplikimi i ofertës anomalisht të ulët bëhet vetëm mbi ofertat që ***përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të vlefshme***. Sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për rivlerësimin e ofertës anomalisht të ulët mbështetur në përcaktimet ligjore të sipërcituara.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik

gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbylljë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik Besim Ksamberi, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar- mallra”, me Nr. REF:48564-05-21-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrimi”, me fond limit 2.200.000 (dy milion e dyqind mijë) lekë pa TVSH zhvilluar më datë 03.06.2025, nga autoriteti kontraktor Bashkia Rrogozhinë
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik Besim Kamberi për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar- mallra”, me Nr. REF:48564-05-21-2025, me objekt: “Blerje materiale pastrimi”, me fond limit 2.200.000 (dy milion e dyqind mijë) lekë pa TVSH zhvilluar më datë 03.06.2025, nga autoriteti kontraktor Bashkia Rrogozhinë.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin për skualifikimin e operatorit ekonomik Besim Kamberi, duke e kualifikuar atë.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik Besim Kamberi.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

